

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 54, paragrafi (1) nga Ligji i cituar, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 të datës 01.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-2421/1 të datës 09.06.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2680/4 të datës 08.07.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 24-ët të mbajtur më 08.07.2026, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) ALSAT - M ShPK Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 54, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në mënyrë që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, transmetuar më 4 maj 2026, në emisionin e sponsorizuar argëtues-dokumentar "1001 Vakte"(1001 obrok), përmes rekomandimi të veçantë promovues, nxit blerjen e dy produkteve të njërit prej sponsorëve të emisionit.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike, specifikohet sipas datës së transmetimit, titullit të transmetimit, periudhës së transmetimit (fillimi dhe mbarimi) në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.10-2421/1 të datës 09.06.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojca nr.1.

2. URDHËROHET që ShTR ALSAT-M ShPK Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LShMAAV-së.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë, kundër botuesi të medias ndërmer masë - paralajmërim publik në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur kemi cenim ose shkelje të dispozitave të LShMAAV-së dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 54, paragrafi (1) të LShMAAV-së, shërbimet ose programet mediatike audio ose audiovizuele të sponsorizuara nuk mund drejtpërdrejt të inkurajojnë blerjen ose marrjen me qira të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht përmes rekomandimit të veçantë promovues.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 08.06.2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi shërbimin programor të ShTR ALSAT-M ShPK Shkup, të transmetuar më 04.05.2026, në nivel shtetëror, ku është kontaktuar shkelje e nenit 54, paragrafi (1) të LShMAAV-së.

Konkretisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se në edicionin reprizë të programit të sponsorizuar "1001 Vakte" (1001 obrok), emision dokumentar argëtues me funksion argëtues, i transmetuar më 4 maj 2026 (në periudhën nga ora 04:05:02 deri në 04:52:04), në mënyrë të veçantë rekomandohet dhe nxitet blerja e dy produkteve nga brendet - "Raid" dhe "Autan" e njërit prej sponsorëve të programit – kompanisë

"SC Johnson", e cila është shënuar në mënyrë të veçantë si sponzor i emisionit, dhe nga prezantuesi ashtu edhe me mjete vizuale (gjatë dhe në fund të emisionit). Dy produktet për mbrojtje nga insektet nga markat "Raid" dhe "Autan" nga kompania "SC Johnson" janë dukshëm të theksuar në skenografi gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, dhe inkurajim i drejtpërdrejtë për blerjen e tyre bëhet me një rekomandim të veçantë promovues në dy segmente programore të emisionit dedikuar produkteve të sponsorit, të cilat nga përmbajtja janë entitete të ndara, por teknikisht nuk janë të ndara ose të shënuara. Rekomandimi i veçantë promovues bëhet si vizualisht (me inçizime të pamjeve të mëdha dhe afatgjata të markave tregtare dhe paketimeve të produkteve të njohura) edhe verbalisht (përmes fjalimit të prezantuesit, i cili përfundon me inkurajim (nxitje) të drejtpërdrejtë që produktet duhet të mbahen në shtëpi). Deklaratat dhe (citimet) e prezantuesit që përmbajnë inkurajimin e drejtpërdrejtë për të blerë produktet janë renditur në pikën "7. Gjetjet e mbikëqyrjes" të Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, nr.ark.10-2421/1 të datës 09.06.2026, në të cilën specifikohet shkella sipas datës së transmetimit, titullit të emisionit dhe periudhës së transmetimit (fillimi dhe mbarimi), i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojca nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë ShTR ALSAT - M ShPK më 11.06.2026, i dërgoi Shkresë me nr.ark.10-2421/2 të datës 11.06.2026, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.10-2421/1 të datës 09.06.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaram me shkrim në lidhje me shkeljen e kryer të dispozitave të LShMAAV-së. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 12.06.2026. Në afatin e parashikuar, ShTR ALSAT - M ShPK Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 08.07.2026, shqyrtoi Raportin në fjalë me shkrim dhe arriti në përfundimin se ndaj ShTR ALSAT - M ShPK Shkup të shqiptohet masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 54, paragrafi (1) nga Ligji i cituar, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.10-2421/1 të datës 09.06.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LShMAAV-së, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 24-ët të mbajtur më 08.07.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-2680/4 të datës 08.07.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShTR ALSAT - M ShPK Shkup, dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV-së. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV-së, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij botuesi i medias (transmetuesi) mund të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.10-2421/1 të datës 09.06.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani

